



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1217/ 5 prot.

Datë 30 .04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 575 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft office” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” , me Nr. REF-82084-04-15-2026, me objekt: “Blerje kënde lodrash dhe palestrimi për ambiente të jashtme” me fond limit 13,128,964.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur” , me Nr. REF-82084-04-15-2026, me objekt: “Blerje kënde lodrash dhe palestrimi për ambiente të jashtme” me fond limit 13,128,964.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: *Rruga Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.*

**Autoriteti Kontraktor:**

Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare, *me adresë: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.*

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është “E hapur”, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik të ndryshuara.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-82084-04-15-2026, me objekt: “Blerje kënde lodrash dhe palestrimi për ambiente të jashtme” me fond limit 13,128,964.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.

II.2. Në datën 21.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.1217/2026 protokoll, dhe protokolluar pranë KPP, datë 21.04.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6570, e operatorit ekonomik “Infosoft Office ” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumentave të tenderit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën me nr. 465/8 prot., me datë 27.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1217/1 prot., me datë 28.04.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga OE “InfoSoft Office” shpk
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

...

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft office ” sh.p.k për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1. 2. Me shkresën me nr. 465/8 prot., me datë 27.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1217/1 prot., me datë 28.04.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga OE “InfoSoft Office” shpk
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me*

ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës me 465/8 prot., me datë 27.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1217/1 prot., me datë 28.04.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës .

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office ” sh.p.k

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office ” sh.p.k , me arsyen se :

... [Operatori ynë ekonomik nuk kundërshton kriterin në tërësi, por vetëm kërkesën për të përcaktuar detyrimisht tek oferta teknike tek të dhënat e kompanisë prodhuese, adresën ËEB. Kjo kërkesë e përcaktuar nga AK-ja, nuk duhet të jetë detyruese për ofertuesit, pasi nuk është në zgjedhjen dhe në dorën e ofertuesve, fakti nëse prodhuesit e mallrave objekt prokurimi vendosin të kenë adresë në ëeb ose jo. Ndërtimi dhe krijimi i faqëve në ëeb, nga na e prodhuesve është një zgjedhje dhe vendimmarrje e tyre. Gjithashtu edhe sasia e informacioneve dhe çfarë vendosin të bëjnë publike në këto faqe ëeb nëse kanë të tilla, është gjithashtu një zgjedhje dhe vendimmarrje e tyre dhe jo e ofertuesve. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kritere kualifikimi në këtë tender, të gjithë dokumentacionin e mundshëm teknik që mund të kërkohet si, autorizim prodhuesit apo distributori zyrtar, katalogë apo broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/ëve të lëshuar nga prodhuesi, certifikatat/deklaratat e konformitetit ose të performancës të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione të pavaruara të akredituara, pra të gjithë dokumentacionin teknik të lëshuar nga prodhuesi i tyre, ku mund të bëjë të gjitha verifikimet nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga AK-ja në dokumentat e tenderit. Në këto kushte kërkesa e AK-së për të vendosur detyrimisht tek oferta teknike të dhënat ëeb të faqes së interneti të prodhuesve është e ekzagjeruar dhe jo gjithmonë e mundshme për tu realizuar, pasi nuk ka asnjë rregull teknik që të përcaktojë detyrimin që prodhuesit duhet të kenë një faqe të tyre në ëeb për të reklamuar dhe publikuar mallrat e prodhuara prej tyre. Rregullat e prokurimit publik përcaktojnë qartë që kërkesat drejtuar operatorëve ekonomikë duhe të jenë të mundshme dhe në proporcion me objektin e prokurimit. Në pikën 1 të nenit 77 Kërkesat për kualifikim, të ligjit nr.162/2020 Për prokurimin publik , I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: ?Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës? Për gjithë sa më sipër kërkohet që nga kriteri për kualifikim i përcaktuar në pikën 2.3.5 të shtojcës 8 (KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT) ku është kërkuar: ...2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertë teknike, në formën e një tablele, kërkesat e të cilit

duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për produktet objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë: Nr Emërtimi i produkteve Emërtimi kompanisë prodhuese, adresa, ëeb-i katalogut Kodi i produktit ose nr. faqes në katalog. Emertimi i Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës të paraqitur nga AK. Emri, Adresa dhe ëebsite i kompanisë prodhuese, me produktet e të cilëve operatori ekonomik do të paraqitet në ofertim, emërtimi i katalogut të prodhuesit, referenca në katalog, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes në katalogun përkatës ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK..... ,KËRKOJMË të hiqet detyrimi për të dhënë të dhënat në ËEB të kompanisë prodhuese, por të përcaktohen të dhëna të mundshme si, adresa e emailit, numer kontakti tel/cel Pra kriteri 2.3.5 i shtojcës 8 të DT-së të ndryshojë dhe të bëhet; ...2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertë teknike, në formën e një tablele, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për produktet objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë: Nr Emërtimi i produkteve Emërtimi kompanisë prodhuese, adresa, adresa e-mail, numër kontakti tel/cel, etj Emertimi i katalogut Kodi i produktit ose nr. faqes në katalog. Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës të paraqitur nga AK. Emri, Adresa dhe ëebsite i kompanisë prodhuese, me produktet e të cilëve operatori ekonomik do të paraqitet në ofertim, emërtimi i katalogut të prodhuesit, referenca në katalog, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes në katalogun përkatës ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK..... , IV Në lidhje me kriterin për kualifikim,...], Komisioni i prokurimit publik vë re se,

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 8 “ Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, ka parashikuar si në vijim kriterin,

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertë teknike, në formën e një tablele, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për produktet objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese, adresa, ëeb-i	Emertimi i katalogut	Kodi i produktit ose nr. faqes në katalog.
----	-----------------------	---	----------------------	--

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës të paraqitur nga AK. Emri, Adresa dhe ëebsite i kompanisë prodhuese, me produktet e të cilëve operatori ekonomik do të paraqitet në ofertim, emërtimi i katalogut të prodhuesit, referenca në katalog, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes në katalogun përkatës ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve

ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.3. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.6 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2. Komisioni referuar kriterit në pikën 2.3.5 të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit si dhe duke para pretendimin e operatorit të argumentuar vlerëson se, në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë transparencën, konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë të ofertuesve, Autoriteti Kontraktor nuk duhet të përcaktojë si kriter të detyrueshëm që prodhuesi i mallrave ose shërbimeve objekt prokurimi të ketë një adresë ëebi, apo që oferta teknike të përmbajë informacion në lidhje me faqen ëeb të prodhuesit. Kjo sepse vendimi për të krijuar dhe mirëmbajtur një faqe ëebi është një prerogativë e prodhuesit dhe nuk ndikohet nga ofertuesi. Për më tepër, përmbajtja, sasia dhe lloji i informacionit që prodhuesi zgjedh të bëjë publik në faqen e tij ëeb janë çështje të natyrës private dhe të autonomisë së prodhuesit, dhe nuk mund të konsiderohen si elemente të një vlerësimi objektiv të ofertës. Vendosja e një kriteri të tillë do të krijonte një barrë të padrejtë për ofertuesit dhe mund të cenonte konkurrencën e lirë, duke favorizuar ofertuesit që punojnë me prodhues më prezent online, pavarësisht nga cilësia ose përshtatshmëria e mallrave ose shërbimeve të ofruara. Për këtë arsye, kërkesa për adresë ëebi nuk duhet të konsiderohet e detyrueshme në procesin e prokurimit dhe nuk mund të jetë kusht për pranimin ose vlerësimin e ofertës.

Për më tepër, nga pikëpamja e proporcionalitetit të objektit të prokurimit dhe relevancës së kriterëve, çdo kërkesë e vendosur duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit dhe performancën reale të mallrave ose shërbimeve, duke shmangur kriteret që nuk kontribuojnë në vlerësimin teknik ose ekonomik të ofertës. Në këtë kontekst, kërkesa për adresë ëebi nuk përmbush kriteret e proporcionalitetit dhe relevancës, dhe nuk duhet të përdoret si kusht për pranimin ose vlerësimin e ofertës.

Ky parashikim siguron që procesi i prokurimit të mbetet konkurrues, transparent dhe i barabartë për të gjithë ofertuesit, duke ruajtur parimin që informacioni publik i prodhuesit është çështje e autonomisë së tij dhe jo e ofertuesit, dhe duke garantuar respektimin e praktikave më të mira administrative dhe ligjore të zbatueshme në vend. Ndaj për sa më sipër Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron .

III.3. Lidhur me pretendimin se operatorit ekonomik ankimues me arsyen se :...[Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Kapaciteti teknik të shtojcës 8 (Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ KUALIFIKIMIT) të DT-së, me përmbajtjen si më poshtë: Emërtimi ?2.3.6 Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesë nga 1 mostër për zerat objekt prokurimi si me poshte: Nr Njësia Sasia 1 2 3 4 5 6 7 Lojë e kompozuar me rreshkitëse dhe lisharëse copë Rrotulluese me timon Peshore për 2 fëmijë Lëkundës me sustë tipi 1 copë

copë Pasisje palestrimi FTN 2509 Paisje palestrimi FTN 2502 Tapet gome m? 1 1 1 1 copë copë copë 1 1 1 Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre? , **KËRKOJMË QË KY KRITER TË HIQET SI KRITER. ARGUMENTOJMË:** Nga ana e njësisë së prokurimit kriteri për praqitjen e mostrave, në procesverbalin e hartimit të dokumentave, është argumentuar si më poshtë vijon: ...Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik të ndryshuar ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik të ndryshuar, ku përcaktohet se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund tu kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; . Ky kriter kualifikimi ka për qëllim të sigurojë që operatori ekonomik të ofrojë produkte të verifikueshme dhe të krahasueshme në terren, duke mundësuar një vlerësim të saktë të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Kërkesa për dorëzimin e mostrave fizike në ditën dhe orën e hapjes së ofertave është një procedurë standarde që synon të eliminojë çdo pasiguri në lidhje me cilësinë, dimensionet dhe funksionalitetin e pajisjeve që do të furnizohen, duke lehtësuar një kontroll të drejtpërdrejtë dhe objektiv. Sa i përket secilës mostër të kërkuar, argumentimi teknik është si vijon: Loja e kompozuar me rrëshkitëse dhe lisharëse, një copë, duhet të dorëzohet për të verifikuar dizajnin e integruar të elementëve lojërorë, qëndrueshmërinë strukturore dhe sigurinë për përdorim nga fëmijët. Mostra duhet të përputhet me materialet, dimensionet dhe përmasat që janë përcaktuar në specifikimet teknike dhe të demonstrojë funksionimin e sigurt të rrëshkitëses dhe lisharëses, duke u fokusuar në stabilitetin dhe lidhjen e elementëve. Rrotulluese me timon, një copë, shërben për të kontrolluar funksionimin mekanik të komponentëve të lëvizshëm dhe ergonominë për përdoruesin. Mostra e dorëzuar duhet të demonstrojë qarkullimin e sigurt dhe të lehtë të timonit dhe të garantojë që lëvizja të jetë e kontrollueshme dhe pa rrezik për fëmijët. Peshore për dy fëmijë, një copë, duhet të prezantojë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e materialeve të përdorura, si dhe saktësinë e matjes. Mostra e dorëzuar mundëson vlerësimin e dimensioneve dhe funksionit të saj, duke garantuar që të përmbushë kërkesat për përdorim të përbashkët nga dy fëmijë njëkohësisht pa rrezik. Lëkundës me sustë tipi I është i nevojshëm për të vlerësuar mekanizmat e sustave, elasticitetin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e elementëve që lejojnë lëkundjen e kontrolluar. Mostrat do të testohen për rezistencë ndaj ngarkesës, stabilitet në përdorim dhe përputhshmëri me dimensionet e specifikuara. Paisje palestrimi FTN 2509 dhe

FTN 2502, secila një copë, dorëzohen për të verifikuar cilësinë e materialeve, përputhshmërinë me dimensionet dhe dizajnin e përcaktuar në dokumentet teknike, si dhe funksionalitetin dhe sigurinë për aktivitetet fizike në ambiente të jashtme. Mostrat duhet të demonstrojnë që materialet janë rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit të vazhdueshëm. Tapeti gome, një metër katror, është i domosdoshëm për të kontrolluar trashësinë, densitetin dhe qëndrueshmërinë e materialit, përveç aftësisë për drenazh uji dhe rezistencës ndaj ndikimeve atmosferike. Mostra duhet të demonstrojë që përbërja e gomes dhe metoda e prodhimit përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike, duke siguruar siguri dhe stabilitet për përdoruesit. Për secilën prej mostrave, kërkesa për pranimin e ekuivalentëve pranohen vetëm në rast se ato plotësojnë të njëjtat standarde dhe parametra teknike si artikulli i kërkuar. Kjo siguron fleksibilitet në furnizim pa cenuar përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë, funksionalitetit dhe cilësisë. Paraqitja e mostrave fizike për secilin produkt lejon autoritetin kontraktor të kryejë një verifikim të drejtpërdrejtë dhe objektiv të ofertës, duke siguruar që produktet përfundimtare të përmbushin standardet e kërkuara për përdorim në ambientet e jashtme të fëmijëve? Në Nenin 21 Autoriteti ose enti kontraktor të ligjit 162/2021 Për prokurimin publik , i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. . Në pikën 1 dhe 4 të nenit 77 Kërkesat për kualifikim, të ligjit nr.162/2020 Për prokurimin publik , I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: ?Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës? 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën? . Neni 40 Kërkesa të veçanta për mallrave , pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund tu kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, utoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare,

të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike... . Rregullat e prokurimit public parashikojnë që përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. SË PARI: Në rastin e procedurës së prokurimit objekt I kësaj ankese, AK-ja për të verifikuar pëmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi, ka kërkuar të gjithë dokumentacionin e mundshëm teknik që mund të kërkohej si, autorizim prodhuesit apo distributori zyrtar, katalogë apo broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/ëve të lëshuar nga prodhuesi, certifikatat/deklaratat e konformitetit ose të performancës të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione të pavaruara të akredituara, pra të gjithë dokumentacionin teknik të lëshuar nga prodhuesi i tyre, ku mund të bëhen të gjitha verifikimet nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga AK-ja në dokumentat e tenderit. Në këto kushte kërkesa e AK-së për të paraqitur edhe mostra të produkteve në vlerësimin tonë është e ekzagjeruar, jo në prporcion me në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. SË DYTI: Mallrat objekt I këtij prokurimi, të cilat janë lodra dhe kënde palestrimi, janë produkte të cilat nuk i gjen gjërësisht në treg, nuk kanë një përdorim të gjerë në treg dhe referuar specifikimeve teknike të kërkuara për këto mallra ato janë produkte të cilat do të porositen tek prodhuesit e tyre posacërisht për këtë procedurë prokurimi dhe kërkesa për të paraqitur mostra për 7 produkte, I sjell një kosto të paargumentuar operatorëve ekonomikë, pasi përvec kompanisë e cila do të zgjidhet fituese, për kompanitë e tjera pjesmarrëse kostoja për të siguruar këto mostra tek prodhuesit e tyre është e pakthyeshme, pasi sic e cituam edhe më sipër këto artikuj nuk kanë një përdorim të gjerë në treg që të mund të shiten lehtësisht tek të tretët. Për pasojë një kërkesë e tillë kufizon dhe pengon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë. SË TRETI: Sic e theksuam edhe më sipër, Mallrat objekt i këtij prokurimi, janë lodra dhe kënde palestrimi, janë produkte të cilat nuk i gjen gjërësisht në treg, janë mallra importi, pra që nuk prodhohen në vend. Edhe nëse operatorët ekonomik do të marrin përsipër kostot paraprake për të siguruar mostrat e kërkuara nga AK-ja, koha që duhet për ti porositur dhe sjellë në Shqipëri është e pamjaftueshme për ti praqitur këto si mostra në ditën e tenderit, pra është një kërkesë e cila është e vështirë për tu realizuar për shkak të natyrës së mallrave objekt prokurimi dhe kohës minimale që u duhet OE për ti siguruar këto mostra nga prodhuesit. Në kushtet kur AK-ja ka kërkuar të gjithë dokumentacionin e mundshëm teknik dhe ligjor, në vlerësimin tonë kërkesa për dorëzimin e mostrave është e ekzagjeruar, sjell kufizime për pjesmarrjen në tender të ofertuesve në mënyrë të papargumentuar, nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe nuk është një kërkesë proporcionale me objektin e kontratës. Rregullat e prokurimit public kërkojnë që kërkesat të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës....].

III. 3.1 Autoriteti kontraktor në shtojcën 8 të dokumumentave standarte ka parashikuar si në vijim kriterin,

2.3.6 *Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesë nga 1 mostër për zerat objekt prokurimi si me poshte:*

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Lojë e kompozuar me rreshkitëse dhe lisharëse	copë	1
2	Rrotulluese me timon	copë	1
3	Peshore për 2 fëmijë	copë	1
4	Lëkundës me sustë tipi 1	copë	1
5	Pasisje palestrimi FTN 2509	copë	1
6	Paisje palestrimi FTN 2502	copë	1
7	Tapet gome	m <sup>2</sup>	1

*Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

III.3.2. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që 26 operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

III.3.4 Neni 40 “Kërkesa të veçanta për mallrave”, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor

mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e 27 natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.3.6 Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriterë të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave, por KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave për artikujt të veçantë të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, nuk është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Referuar

materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe kthimit të përgjigjes lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë, se përse është e nevojshme paraqitja e mostrave të caktuara për këtë procedurë prokurimi. Mostra në vetvete ka qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, qëllim i cili përmbushet nga operatorët ekonomikë me paraqitjen e skedës teknike ose katalogëve, të cilët autoriteti kontraktor në mënyrë alternative i ka kërkuar si kusht për kualifikim në pikën 2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/ëve të lëshuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke pasqyruar qartë të gjitha të dhënat teknike të kërkuara, skicat e paisjeve dhe lodrave, plan vendosjet e tyre, gjithashtu të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet përkatëse të kërkuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DT, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme*, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se verifikimi i përputhshmërisë së specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor me specifikimet teknike të artikujve, sigurohet nga operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit edhe përmes paraqitjes së skedës teknike apo katalogut siç është përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.3.6 të “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, lidhur me paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt objekt prokurimi është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me qëllimin e lex specialis si dhe rregullat e prokurimit publik, të cilat kanë si synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri për kualifikim nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1.Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft office” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” , me Nr. REF-82084-04-15-2026, me objekt: “Blerje kënde lodrash dhe palestrimi për ambiente të jashtme” me fond limit 13,128,964.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.

2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-82084-04-15-2026, me objekt: “Blerje kënde lodrash dhe palestrimi për ambiente të jashtme” me fond limit 13,128,964.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe vendimit të KSHA si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft office” SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

